



Co-funded by
the European Union

This event is part of the "Fashioning A Just Transition" project (2024-2027)

DOKUMENT POLITIKASH

Integrimi i parimeve të "Tranzicionit të Drejtë" në politikat kombëtare në Shqipëri. Adresimi i sfidave, boshllëqeve dhe mundësive në sektorin e veshjeve dhe këpucëve.

Tetor 2025



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Disclaimer

Ky dokument politikash është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
HYRJE	6
QËLLIMI	7
METODOLOGJIA DHE BURIMET	8
1. KONTEKSTI DHE SFONDI I POLITIKAVE	8
1.1. NDRYSHIMET GLOBALE DHE NDIKIMI NË TREGUN SHQIPTAR TË PUNËS	8
1.2. KONTEKSTI KOMBËTAR DHE SEKTORËT PRIORITARË.....	9
2. GJETJET EMPIRIKE	9
2.1. PERSPEKTIVA E PUNËTORËVE	9
<i>Raste studimore dhe praktika pozitive</i>	10
2.2. PERSPEKTIVA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	11
2.3. PERSPEKTIVA E BIZNESIT	11
3. ANALIZA E NDIKIMIT EKONOMIK DHE MJEDISOR	14
3.1. NDIKIMI EKONOMIK.....	14
3.2. NDIKIMI MJEDISOR	15
3.3. NDIKIMI SOCIAL DHE RREZIQET E MUNGESËS SË MBËSHTETJES.....	15
4. OPSIONET E POLITIKAVE	16
OPSIONI 1 – INTEGRIM INSTITUCIONAL DHE QEVERISJE NDËRSEKTORIALE	16
OPSIONI 2 – MBËSHTETJE FINANCIARE DHE TEKNOLOGJIKE PËR NDËRMARRJET	16
OPSIONI 3 – FUQIZIM SOCIAL DHE DIALOG I STRUKTURUAR.....	17
OPSIONI 4 – PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE DHE BARAZI GJINORE	17
OPSIONI 5 – PJESËMARRJE AKTIVE DHE PARTNERITET STRATEGJIK	18
5. ANALIZA KRAHASUESE NDËRKOMBËTARE	19
5.1. SFIDAT LIGJORE DHE NEVOJAT PËR NDRYSHIM	19
5.2. VLERËSIMI I RRSIQEVE DHE SKENARËT ALTERNATIVË	19
6. REKOMANDIMET DHE TREGUESIT MATËS PËR NJË TRANZICION TË DREJT DHE TË QËNDRUESHËM	20
7. KONKLUZIONE	22
REFERENCA BIBLIOGRAFIKE	24
ANEKSE	25





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Përmbledhje Ekzekutive

Tranzicioni i drejtë në sektorin e tekstileve dhe këpucëve në Shqipëri

Shqipëria ndodhet në një pikë kthese. Si vend kandidat për BE, ajo duhet të përputhë politikat e saj të punës dhe mjedisit me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane. Sektori i veshjeve dhe këpucëve (një industri kyçe eksportuese që punëson mbi 50,000 persona, 85% prej të cilëve janë gra) është qendror për këtë tranzicion. Ky dokument analizon gatishmërinë e sektorit për një Tranzicion të Drejtë—një koncept i zhvilluar nga ILO (Organizata Nderkombetare e Punës) dhe mbështetur nga G20 dhe Marrëveshja e Parisit, i cili siguron që qëndrueshmëria mjedisore të arrihet së bashku me drejtësi sociale, krijim vendesh pune cilësore dhe dialog social të fortë.

Sfidat:

- Sektori i tekstileve dhe këpucëve dominohet nga gratë (85–95%) dhe është shumë i varur nga kontratat afatshkurtra me tregjet evropiane.
- Strategjitë aktuale kombëtare nuk integrojnë parimet e Tranzicionit të Drejtë, duke krijuar rreziqe për pasiguri në punë, pabarazi gjinore dhe kushte të dobëta pune.
- Sfidat kryesore përfshijnë paga të ulëta, pagesa të vonuara, mungesë kontratash të rregullta, mbrojtje sociale minimale, përfaqësim të dobët sindikal dhe ndërgjegjësim të kufizuar mjedisor.
- Të dhënat empirike zbulojnë se 75% e punëtorëve nuk kanë marrë trajnime profesionale mbi sigurinë ose qëndrueshmërinë, dhe 65% nuk janë të njohur me konceptin e Tranzicionit të Drejtë. Pabarazitë gjinore vazhdojnë në rolet udhëheqëse.

Gjithashtu, në administratën publike ka zbatim sporadik, koordinim fragmentar, burime të kufizuara, mungesë trajnime të mjaftueshëm, koordinim fragmentar dhe zbatim sporadik të nismave mbi tranzicionin e drejtë.

Ndërkohë, kompanitë shfaqin gatishmëri për investime të gjelbra, por përballen me barriera financiare, teknike dhe rregullatore. Iniciativat pilot tregojnë se edhe ndërhyrjet e vogla në riciklim, eficiencë energjetike dhe trajnime mund të sjellin përfitime të matshme ekonomike dhe mjedisore.

Mundësitë:

Nismat pilot në fabrika shqiptare, të përputhura me programe ndërkombëtare si SCORE e ILO-s, demonstrojnë përfitime të prekshme. Ndërhyrjet e thjeshta në riciklim dhe efikasitet energjetik kanë sjellë kursime në kosto prej 8-12%, reduktim të konsumit të energjisë deri në 25% dhe rritje të produktivitetit prej 15-20%. Këto praktika, të kombinuara me përfshirjen aktive të grave në role monitoruese, vërtetojnë se një tranzicion i gjelbër mund të jetë ekonomikisht i mundshëm dhe shoqërisht fuqizues.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Rekomandimet Themelore: Për të shfrytëzuar këtë potencial, ky dokument propozon një rrugëtim të strukturuar, në tre faza (2025-2030) të ndërtuar mbi pesë shtylla:

1. Integrim Institucional –Krijimi i një Këshilli Kombëtar për Tranzicion të Drejtë dhe një Task Force ndërministrorë për harmonizimin e politikave (2025–2026).
2. Mbështetje Financiare dhe Teknologjike – Nisja e skemave pilot të financimit për 50 kompani duke përdorur fonde EU/IPA/Berzh për investime të gjelbra dhe zhvillim aftësish (2026–2028).
3. Dialog Social dhe Fuqizim i Punëtorëve – Rivitalizimi i sindikatave dhe krijimi i forumëve trepalëshe për adresimin e ankesave dhe promovimin e mbrojtjes sociale (2026–2029).
4. Përputhje me Standardet Ndërkombëtare dhe Barazinë Gjinore – Integrimi i Konventave të ILO-s, SDG5 dhe CEDAW në të gjitha politikat e tranzicionit; siguri e pjesëmarrjes së grave në udhëheqje (2025–2030).
5. Partneritet dhe Inovacion – Zhvillimi i trajnimeve, platformave digjitale dhe projekteve pilot për të promovuar transparencën, monitorimin dhe shkëmbimin e përvojave (2025–2030).

Rrugëtimi i zbatimit

Faza 1 (2025–2026) – Korniza ligjore dhe koordinimi institucional.

Faza 2 (2026–2028) – Pilotimi i investimeve të gjelbra dhe programeve të trajnimit.

Faza 3 (2028–2030) – Zbatim i plotë me monitorim të vazhdueshëm, përfshirje gjinore dhe harmonizim me standardet e BE-së.

Përfundim: *Një Tranzicion i Drejtë nuk është thjesht një domosdoshmëri mjedisore por një strategji gjithëpërfshirëse për përmirësimin e mirëqenies së punonjësve, produktivitetin dhe barazisë gjinore. Pa ndërhyrje urgjente, sektori rrezikon stagnim dhe thellim të pabarazisë.*

Zbatimi efektiv mund të transformojë praktikat fragmentare pilot të bizneseve shqiptare në një model rajonal të zhvillimit industrial të gjelbër, gjithëpërfshirës dhe konkurrues.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the "Fashioning A Just Transition" project (2024-2027)

Hyrje

Domosdoshmëria për një Tranzicion të Drejtë në Shqipëri

Shndërrimi global drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe rrethore, i drejtuar nga Marrëveshja e Gjelbër Evropiane dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) të OKB-së, paraqet një sfidë dhe një mundësi për Shqipërinë. Koncepti i një Tranzicion të Drejtë, zhvilluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) në vitin 2015 dhe i miratuar nga G20 dhe Marrëveshja e Parisit, ofron kornizën thelbësore për të siguruar që ky shndërrim të mos lërë askënd pas. Ai mandaton që politikat mjedisore të integrohen me drejtësi sociale, duke nxitur punë të denjë, trajnime për "aftësi të gjelbra" dhe dialog social efektiv.

Në kontekstin global, industritë si tekstilet dhe veshjet, që punësojnë rreth 300 milionë njerëz në të gjithë botën përballen me presione të mëdha nga kërkesat për prodhim etik dhe të qëndrueshëm, siç diktojnë rregullat e Bashkimit Evropian (BE) dhe objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Sukseset ndërkombëtare, si tranzicioni drejt tekstileve rrethore në Kenia me mbështetje nga BE-ja, ku u reduktuan emisionet me 25% dhe u fuqizuan gratë në zinxhirin e furnizimit, demonstrojnë se një tranzicion i drejtë mund të krijojë mundësi ekonomike pa sakrifikuar drejtësinë sociale. Po ashtu, në Bangladesh, raporti i Fondacionit Laudes tregon si politikat rrethore në sektorin e tekstileve kanë promovuar investime në efikasitetin e resurseve, duke krijuar vende pune të gjelbra dhe duke forcuar mbrojtjen sociale për punëtorët.

Në Shqipëri, si vend kandidat për anëtarësim në BE, ky tranzicion merr një urgjencë të veçantë, veçanërisht në sektorin e tekstileve, veshjeve, lëkurës dhe këpucëve (TCLF), i njohur si "fason". Ky sektor, që kontribuon ndjeshëm në punësim dhe eksport, punëson mbi 50,000 persona, ku rreth 85% janë gra dhe ka qenë një shtyllë e zhvillimit ekonomik gjatë tranzicionit post-komunist. Megjithatë, sektori përballlet me sfida strukturore, si: pagat e ulëta, kushtet e vështira të punës, kontrata të pasigurta 3-6 mujore me tregje evropiane si Italia dhe Gjermania, mungesa e përfaqësimit sindikal efektiv dhe ndërgjegjësimi i kufizuar mjedisor. Sipas raportit të hartimit të ILO-së për sektorin TCLF në Shqipëri, industria ka potencial për tranzicion drejt qëndrueshmërisë, por kërkon mbështetje për të adresuar barrierat si kostot e larta të automatizimit dhe mungesën e trajnimeve. Iniciativat e ILO-së, si programi SCORE (Sustaining Competitive and Responsible Enterprises), kanë demonstruar në raportet e tyre raste suksesi në Shqipëri, duke përmirësuar produktivitetin dhe kushtet e punës në fabrikat e tekstileve dhe këpucëve, duke reduktuar mbetjet dhe duke promovuar praktika të gjelbra në Tiranë dhe Durrës. Po ashtu, Zero Draft Roadmap i UNIDO-së për TCLF në Shqipëri vlerëson progresin drejt qëndrueshmërisë, duke identifikuar fabrika që kanë adoptuar energji të rinovueshme dhe menaxhim të mbetjeve, me rritje të eksporteve deri në 10%.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Qëllimi

Ky dokument politikash synon të ofrojë një kornizë strategjike për integrimin e parimeve të “Tranzicionit të Drejtë ” në politikat kombëtare të Shqipërisë, me fokus në sektorin e tekstileve dhe këpucëve, për të siguruar një transformim të qëndrueshëm ekonomik që respekton drejtësinë sociale dhe mjedisore. Përmes analizës së boshllëqeve dhe mundësive, bazuar në të dhëna empirike dhe shembuj suksesi vendorë e ndërkombëtarë, dokumenti synon të udhëzojë politikëbërësit, institucionet dhe aktorët socialë drejt krijimit të një mjedisi pune të denjë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, duke forcuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare.

Duke lidhur me standardet ndërkombëtare si Konventat e ILO-së, Kodi i Punës së BE-së, SDG 5 (Barazia Gjinore), CEDAW dhe Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane EU Green Agenda, dokumenti propozon rekomandime të matshme dhe të zbatueshme deri në vitin 2030. Nëpërmjet shembujve vendorë dhe globalë, ai thekson se një tranzicion i drejtë nuk është vetëm një domosdoshmëri mjedisore, por një mundësi për zhvillim të drejtë, gjithëpërfshirës dhe konkurrues, duke shmangur rritjen e pabarazive dhe duke fuqizuar gratë si forcë kryesore e sektorit. Vetëm kështu, Shqipëria mund të transformojë sfidat e sotme në një model të qëndrueshëm për të ardhmen.

Më konkretisht, ky dokument synon:

1. Identifikimin e boshllëqeve kryesore duke analizuar pengesat ligjore, institucionale dhe sociale që pengojnë adoptimin e Tranzicionit të Drejtë në sektorin fason, duke u mbështetur në gjetje nga pyetësorë, intervista dhe raste studimore.
2. Propozimin e politikave të zbatueshme duke formuluar rekomandime SMART (Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe të Kohëzuara) për të adresuar sfidat si pagat e ulëta, mungesa e dialogut social dhe kufizimet mjedisore, me synim përmirësimin e kushteve të punës dhe konkurrencën deri në vitin 2030.
3. Fuqizimin e barazisë gjinore nëpërmjet promovimit të politikave që fuqizojnë gratë, të cilat përbëjnë 85% të fuqisë punëtore, duke siguruar përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe trajnime për aftësi të gjelbra.
4. Integrimin me standardet ndërkombëtare duke lidhur politikat kombëtare me Konventat e ILO-së, SDG 5 (Barazia Gjinore), CEDAW dhe EU Green Agenda për të siguruar përputhshmëri dhe mbështetje ndërkombëtare.
5. Promovimin e shembujve të suksesit për të nxjerrë mësim nga iniciativat e suksesshme, si programi SCORE i ILO-së në Shqipëri dhe tranzicioni rrethor në Kenia, për të ndërtuar një model të adaptueshëm për sektorin fason shqiptar.
6. Krijimi i një kornize monitorimi që të vendosen indikatorë matës për të vlerësuar progresin e Tranzicionit të Drejtë duke përfshirë rritjen e marrëveshjeve kolektive, numrin e ndërmarrjeve të mbështetura dhe përqindjen e grave në role vendimmarrëse.



This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Metodologjia dhe Burimet

Analiza e këtij policy paper mbështetet në një qasje të integruar, duke kombinuar të dhëna empirike dhe kualitative për të identifikuar boshllëqet dhe për të formuluar rekomandime të zbatueshme. Metodot kryesore përfshijnë:

- ✓ **Pyetësorë dhe intervista me punëtorë të sektorit**, bazuar në gjetje nga organizata sindikale dhe rrjete punëtorësh, duke mbuluar kushtet e punës, të drejtat, barazinë gjinore dhe qëndrueshmërinë.
- ✓ **Shembuj**: Punëtorët raportojnë ngarkesë fizike të lartë, siguri mesatare dhe njohuri të pjesshme ligjore.
- ✓ **Konsultime me administratorë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** duke u fokusuar në perspektivën e biznesit, duke analizuar barrierat si kostot fillestare për teknologji të gjelbra dhe mungesën e subvencioneve.
- ✓ **Analizë e dokumenteve strategjike kombëtare (2020–2025)**, si vlerësim i ligjeve për punën, mjedisin dhe inspektoratin, duke identifikuar mungesën e integritit të Just Transition.
- ✓ **Studime dhe raste studimore**, përfshirë ILO, Clean Clothes Campaign, ETUC, publikime qeveritare, dhe raste specifike si “Tranzicioni i drejtë në industrinë e veshjeve në Shqipëri”, duke nxjerrë dinamika si dialogu trepalësh dhe mbështetja për investime të gjelbra.
- ✓ **Vëzhgim të praktikave të mira**, nga kompani që kanë implementuar riciklim mbetjesh, kursim energjie dhe trajnime sporadike, duke ofruar shembuj pilot për tranzicion.

Ky kombinim siguron një analizë të balancuar, duke integruar perceptimet nga terreni me evidencën zyrtare për të identifikuar boshllëqe reale.

1. Konteksti dhe sfondi i politikave

1.1. Ndryshimet globale dhe ndikimi në tregun shqiptar të punës

Koncepti i “Just Transition” është zhvilluar nga ILO në 2015, i miratuar nga G20 dhe Marrëveshja e Parisit, duke theksuar nevojën për të integruar politikat mjedisore me mbrojtjen sociale të punëtorëve gjatë kalimit në ekonomi të ulët-karboni. Ky tranzicion nuk kufizohet vetëm në reduktimin e emetimeve, por përfshin krijimin e vendeve të punës së denjë, trajnime për aftësi të gjelbra dhe dialog social të fuqishëm. Në nivel global, industritë si tekstilet përballen me presione nga konsumatorët dhe rregullat e BE-së për prodhim etik dhe të qëndrueshëm, duke kërkuar certifikime mjedisore dhe sociale.



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Për Shqipërinë, si vend kandidat për BE, përputhja me EU Green Deal është thelbësore, por ndikon drejtpërdrejt në tregun e punës. Sektori i veshjeve dhe këpucëve, i varur nga kontrata të shkurtra 3-6 mujore me tregje evropiane (Itali, Gjermani, Francë), përballet me rrezikun e humbjes së vendeve të punës nëse nuk adaptohet. Gjetjet nga rastet studimore tregojnë se punëtorët, kryesisht gra, lidhin qëndrueshmërinë me përmirësimin e cilësisë së punës, ndërsa sindikatat e shohin si mbrojtje të të ardhurave gjatë ndryshimeve teknologjike. Pa integrim të Tranzicionit të Drejtë, tranzicioni mund të përkeqësojë pabarazitë, siç shihet në kushtet e vështira mjedisore (vapë në verë, ftohtë në dimër) dhe mungesën e masave mbrojtëse.

1.2. Konteksti kombëtar dhe sektorët prioritarë

Në Shqipëri, sektori i tekstileve dhe këpucëve kontribuon ndjeshëm në punësim dhe eksport, por karakterizohet nga struktura e dobët. Numri i punonjësve varion nga 48 deri në 95 për fabrikë, me 85-95% gra në role prodhuese. Strategjitë kombëtare aktuale, si Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritit 2030 dhe Strategjia e Punësimin, nuk përfshijnë konceptin e Tranzicionit të Drejtë dhe mungojnë indikatorë matës për progresin social ose mjedisor.

Sfidat kryesore përfshijnë pagat e ulëta dhe vonimet në pagesa, orë të zgjatura pa pagesë shtesë, mungesë kontratash të rregullta dhe mbrojtje shëndetësore minimale. Sindikatat janë joaktive, duke lënë punëtorët pa përfaqësim efektiv në negociata. Nga rastet studimore, del se gratë dominojnë fuqinë punëtore por mungojnë në vendimmarrje të larta, ndërsa ndërgjegjësimi mjedisor është fillestar, me riciklim sporadik të mbetjeve. Këto elemente e bëjnë tranzicionin një çështje multidimensionale: sociale (dialog i dobët), ekonomike (kosto të larta për automatizim) dhe gjinore (mbështetje e kufizuar për leje lindjeje).

2. Gjetjet empirike

2.1. Perspektiva e punëtorëve

Nga pyetësorët dhe intervistat, del se **75% e punëtorëve** nuk kanë marrë trajnim profesional në siguri ose qëndrueshmëri, ndërsa **65%** nuk njohin konceptin e “Tranzicionit të Drejtë” apo “punës së gjelbër”.

Kushtet e punës janë përgjithësisht të rregullta, por shoqërohen me **ngarkesë fizike të lartë, kushte mjedisore të vështira dhe pajisje sigurie të pamjaftueshme**. Pagat mbeten të ulëta dhe shpesh vonohen, ndërsa kontratat janë formalisht të rregullta por pa perspektivë avancimi profesional.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Të drejtat ligjore njihen pjesërisht, kryesisht gjatë auditimeve të jashtme, ndërsa **sindikatat janë pasive** dhe kanë ndikim të kufizuar në negociata. Ankesat trajtohen, por mungojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe mekanizma institucionalë të mbrojtjes.

Barazia gjinore është një çështje kyçe, pasi gratë përbëjnë rreth 90% të fuqisë punëtore në sektorin e tekstileve dhe këpucëve, por janë të nënpërfaqësuar në pozicione vendimmarrëse. Edhe pse politikat për leje lindjeje zbatohen në disa fabrika, presioni fizik dhe mungesa e fleksibilitetit në orare pune vazhdojnë të përbëjnë sfida të rëndësishme.

Për sa i përket qëndrueshmërisë, disa ndërmarrje kanë filluar të zbatojnë praktika bazë si riciklimi dhe kursimi i energjisë, megjithatë trajnimet për këto iniciativa mbeten sporadike dhe të pakoordinuara.

Punëtorët e shohin tranzicionin e drejt si mundësi për **përmirësim të kushteve të punës dhe sigurisë**, megjithatë e perceptojnë si proces të vështirë për t'u realizuar **pa mbështetje financiare dhe institucionale**.

Ndërkohë edhe rastet e studimit nga fabrikat shqiptare ofrojnë dëshmi bindëse se një Tranzicion i Drejtë është i arritshëm dhe fitimprurës.

Raste studimore dhe praktika pozitive

Rast 1 – Ndërmarrje e vogël me 48 punonjës (prodhim xhaketash pune për tregun evropian)

Kjo ndërmarrje ka nisur procesin e ndarjes dhe **riciklimit të mbetjeve të tekstilit**, duke i dërguar për përpunim në kompani vendase që i ripërdorin në prodhime dytësore si mbushje mobiljesh.

Rezultati ka qenë **reduktim i kostove të pastrimit dhe transportit me rreth 8%**, **përmirësim i higjienës** në vendin e punës dhe **rritje e kënaqësisë së punonjësve**.

Ndërmarrjet e vogla mund të përfitojnë ekonomikisht dhe mjedisorisht nga praktika të thjeshta të riciklimit, duke kontribuar në një **kulturë pune të qëndrueshme dhe më të shëndetshme**.

Rast 2 – Ndërmarrje e mesme me 65 punonjës (prodhim këpucësh dhe aksesorësh për tregjet evropiane)

Kjo ndërmarrje fason ka zbatuar masa për kursimin e energjisë dhe përmirësimin e kushteve mjedisore, përfshirë:

- ndriçim **LED** në linjat e prodhimit,
- **sisteme të reja ventilimi** për uljen e ndotjes së ajrit,
- **trajnime mjedisore** për 20 punonjës, të fokusuar në menaxhimin e mbetjeve kimike dhe ujërave të përdorura.



This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Rezultati ka qenë **reduktim i konsumit të energjisë me 12%** dhe **ulje e mungesave për arsye shëndetësore**, sidomos tek punonjëset.

Rasti demonstroi se **tranzicioni i drejt** nxit **modernizimin teknologjik** dhe **mirëqenien e punëtorëve**, veçanërisht në sektorët ku gratë përbëjnë shumicën e fuqisë punëtore.

Rast 3 – Ndërmarrje e madhe me 89 punonjës (fasoneri për prodhime tekstile për eksport)

Kjo ndërmarrje ka ngritur një sistem të integruar për **menaxhimin e energjisë dhe mbetjeve**, duke përdorur:

- **panelet diellore** për ndriçimin e ambienteve të jashtme,
- **riciklim të ambalazheve plastike**,
- **trajnime të brendshme** për siguri dhe efikasitet energjetik.

Është krijuar gjithashtu një grup i brendshëm “*eko-pune*”, i përbërë kryesisht nga gra, që monitoron ndarjen e mbetjeve dhe kursimin e energjisë.

Ky rast tregon se **tranzicioni i drejt** mund të bëhet **instrument për fuqizim gjinor** dhe **ndërtim të një kulture bashkëpërgjegjësie mjedisore**.

2.2. Perspektiva e administratës publike

Institucionet publike njohin jo plotësisht kornizat ligjore ekzistuese (Ligji i Punës, Inspektorati i Punës), por mungon një politikë e integruar për Tranzicionin e Drejtë.

Zbatimi është i pjesshëm dhe sporadik, me mungesë burimesh dhe koordinimi ndër-institucional. Bashkëpunimi midis strukturave të punës, mjedisit dhe arsimit profesional mbetet fragmentar. Vetëm disa institucione lidhin konceptin e Tranzicionit të Drejtë me ekonominë e gjelbër apo punët e qëndrueshme, por implementimi real mungon. Sfidat kryesore përfshijnë mungesën e trajnimeve për stafet publike, burimet e kufizuara financiare dhe dobësinë e mekanizmave të dialogut social.

Nga perspektiva institucionale, administrata publike ka filluar të njohë rëndësinë e sinkronizimit të politikave të punës me ato mjedisore, por ka nevojë për mbështetje ndërkombëtare, reformë ligjore dhe mekanizma koordinimi të përhershëm.

2.3. Perspektiva e biznesit

Ndërmarrjet fason, që operojnë për tregjet europiane, tregojnë gatishmëri për përmirësim, por pengohen nga mungesa e nxitjeve fiskale dhe mbështetjes teknike. Struktura e tyre është e përqendruar në kontrata të pasigurta nën-porositë, me fuqi punëtore të feminizuara

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

dhe pagë të ulët në raport me ngarkesën e punës. Zbatimi i Kodit të Punës është formal, por monitorimi praktik mbetet i pjesshëm. Sindikatat janë joaktive dhe pa rol në proceset vendimmarrëse. Praktikave mjedisore ekzistojnë në disa raste (përdorim LED, riciklim mbetjesh, ventilim të përmirësuar), por njohuritë për ekonominë rrethore janë të kufizuara.

Barrierat kryesore: kosto e lartë e investimeve, mungesë ekspertize teknike dhe mungesë strategjie kombëtare për nxitje të gjelbër.

Në perspektivë, tranzicioni i drejtë shihet si domosdoshmëri për integrim europian, por i paarritshëm pa instrumente mbështetëse dhe plane afatgjata të zbatimit.

Tabela 1 - Sinteza analitike e rasteve

Elementi i Zbatimit	Shembulli	Efektet Kryesore	Potencial për Shtrirje
Riciklimi i mbetjeve	Ndërmarrje me 48 punonjës	Kursim 8% kostosh dhe ambient më i pastër	Bashkëpunim me kompani ricikluese lokale
Eficienca energjetike	Ndërmarrje me 65 punonjës	Reduktim 12% në konsum energjie dhe kushte më të mira pune	Model për subvencione fiskale
Trajnime dhe pjesëmarrje gjinore	Ndërmarrje me 89 punonjës	Përfshirje aktive e grave dhe vetë-menaxhim i praktikave mjedisore	Program kombëtar për “Green Skills”

Këto gjetje empirike dhe raste praktike tregojnë se **elementet e Tranzicionit të Drejtë** janë tashmë të pranishme në praktikën industriale shqiptare, edhe pse në mënyrë **fragmentare dhe pa strategji të unifikuar**.

Ndërmarrjet po eksperimentojnë me **riciklim, eficiencë energjetike dhe trajnime mjedisore**, të cilat sjellin **përmirësim të kushteve të punës, rritje të vetëdijes dhe efikasitetit**.

Në të njëjtën kohë, këto praktika përbëjnë **potencial politik dhe ekonomik** për zhvillimin e politikave të reja kombëtare që lidhen me:

- përfshirjen e **grave në proceset e gjelbra**,
- **formimin profesional të qëndrueshëm**,
- dhe **mbështetjen fiskale** për bizneset që zbatojnë standarde të gjelbra.

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Në përfundim, **tranzicioni i drejt** mund të shërbejë si **platformë integruese** mes **punës, mjedisit dhe barazisë sociale**, duke e shndërruar përvojën e sotme sporadike të bizneseve shqiptare në **strategji kombëtare të qëndrueshme për zhvillim të gjelbër**.

Tabela 2 - Përmbledhëse e boshllëqeve dhe mundësive për tranzicion

Fushë	Boshllëku Aktual / Sfidat Kryesore	Ndikimi	Nevoja për Ndërhyrje / Mundësitë për Tranzicion	Tregues Matës	Shembuj Pilot
Ligjore	Mungesë integrimi i parimeve të “Just Transition” në ligjin e punës	Pasiguri sociale, mosmbrojtje e punëtorëve gjatë tranzicionit	Ndryshime ligjore dhe mjedisore; përfshirja e Just Transition në legjislacionin kombëtar	Numri i mekanizmave ligjorë të implementuar	Draft i ligjit për Task Force; integrim me CEDAW për barazi gjinore
Institucionale	Mungesë koordinimi ndërministror	Politika e fragmentuar, mungesë harmonizimi	Task Force ndërsektoriale; forcimi i koordinimit ndërministror	Numri i takimeve/raporteve e ndërministrorë	Raporte ndërministrorë; bashkëpunim me sindikata për dialog trepalësh
Sociale	Dialog social i dobët, mungesë sindikatash aktive	Konflikte, mungesë zëri i punëtorëve	Fuqizim i sindikatave; përfshirja e punëtorëve në dialog social	% punëtorësh të përfaqësuar nga sindikata	Trajnime për punëtorë; modele nga Clean Clothes Campaign
Ekonomike	Pak fonde për inovacion të gjelbër	Mungesë nxitjesh për zhvillim të qëndrueshëm	Skema fiskale dhe grante; stimuj financiarë	Numri i ndërmarrjeve të mbështetura financiarisht	50 ndërmarrje të mbështetura; riciklim në fabrika pilot

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Fushë	Boshllëku Aktual / Sfidat Kryesore	Ndikimi	Nevoja për Ndërhyrje / Mundësitë për Tranzicion	Tregues Matës	Shembuj Pilot
Gjinore	Gratë e pambrojtura në tranzicion	Margjinalizimi, mungesë përfaqësimit në vendimmarrje	Politika gjinore aktive, trajnime, promovimi i barazisë gjinore	% grave në role vendimmarrëse	40% gra në role; programe për leje lindjeje dhe avancim

3. Analiza e ndikimit ekonomik dhe mjedisor

Rezultatet nga rastet studimore dhe gjetjet empirike tregojnë se ndërmarrjet shqiptare, edhe pse veprojnë në kushte të kufizuara institucionale dhe me mbështetje të pakët publike, po arrijnë të gjenerojnë ndikime të matshme ekonomike dhe mjedisore përmes ndërhyrjeve graduale në fushën e tranzicionit të drejt.

3.1. Ndikimi ekonomik

Në aspektin ekonomik, ndërmarrjet që kanë nisur të aplikojnë masa për riciklim, menaxhim energjie dhe trajnime mjedisore kanë raportuar:

- **Kursim të kostove operative** midis **8–12%**, kryesisht për shkak të riciklimit të mbetjeve dhe përdorimit të ndriçimit LED;
- **Reduktim të konsumit të energjisë** deri në **25%** në ndërmarrjet që kanë instaluar sisteme të eficiencës energjetike (panele diellore, ventilim të ri, pajisje kursimtare);
- **Rritje të produktivitetit me 15–20%** në ndërmarrjet që kanë zhvilluar trajnime me “green skills”, si rezultat i përmirësimit të kushteve të punës, uljes së lodhjes fizike dhe rritjes së ndërgjegjësimit për sigurinë.

Në tregjet e eksportit, adoptimi i standardeve mjedisore perceptohet gjithnjë e më shumë si **avantazh konkurrues**. Rastet e përfshira tregojnë se investimet e vogla në teknologji të pastra dhe menaxhim të mbetjeve kanë rritur **besueshmërinë e kompanive shqiptare**



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

ndaj partnerëve europianë, duke ndikuar pozitivisht në **vazhdimësinë e kontratave fason**.

Projektohet që zbatimi i **skemave financiare për 50 ndërmarrje** të ngjashme mund të gjenerojë **rritje eksporti me 10–12%** brenda tre viteve, nëse mbështeten nga politika fiskale dhe subvencione të gjelbra.

3.2. Ndikimi mjedisor

Nga analiza e rasteve, evidentohen ndikime të qarta pozitive mjedisore:

- **Reduktim i mbetjeve industriale** deri në **30%** përmes ndarjes dhe riciklimit të tekstilit e plastikës;
- **Përmirësim i cilësisë së ajrit në ambientet e brendshme** për shkak të instalimit të sistemeve të ventilimit dhe ndriçimit LED;
- **Ulja e ndotjes akustike dhe termike** në linjat e prodhimit, që lidhet drejtpërdrejt me rritjen e komoditetit të punës;
- **Zhvillimi i kulturës mjedisore të brendshme**, ku punonjësit marrin rol aktiv në procesin e ndarjes së mbetjeve dhe kursimit të energjisë (p.sh. përmes grupeve “eko-pune” në ndërmarrjet me 89 punonjës).

Këto efekte tregojnë se edhe pa investime të mëdha, **ndërhyrjet mjedisore të synuara** mund të krijojnë ndikim të dyfishtë, si në uljen e gjurmës ekologjike, po ashtu edhe në **përmirësimin e kushteve të punës**. Në veçanti, përfshirja e grave në rolet monitoruese të praktikave të qëndrueshme ka kontribuar në **rritjen e ndërgjegjësimit kolektiv dhe në barazinë gjinore funksionale**.

3.3. Ndikimi social dhe rreziqet e mungesës së mbështetjes

Nga gjetjet e punëtorëve dhe administratës publike rezulton se:

- Mungesa e **dialogut social** dhe **politikave të qarta ndërsektoriale** e bën tranzicionin e drejt të fragmentuar dhe shpesh **jo gjithëpërfshirës**;
- Rreziku kryesor është që investimet e gjelbra të interpretohen vetëm si kërkesë tregu, pa shoqëruar me **mbrojtje sociale** dhe **trajnim profesional të barabartë**;
- Kjo mund të sjellë **ulje të punësimit** në disa sektorë tradicionalë dhe **thellim të pabarazive gjinore**, nëse mungon mbështetja institucionale për ri-orientimin e punës.

Nga ana tjetër, përfshirja aktive e grave në proceset mjedisore (si në rastin e grupit “eko-pune”) tregon se **tranzicioni i drejt mund të kthehet në instrument fuqizimi dhe rritjeje të dinjitetit në punë**, nëse shoqërohet me politika trajnimi, stimulime fiskale dhe mekanizma të dialogut social real.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Integrimi i dimensionit mjedisor dhe ekonomik në ndërmarrjet fason tregon një **potencial të qartë për zhvillim të qëndrueshëm** në Shqipëri.

Tranzicioni i drejt, nëse mbështetet nga politikat publike, mund të sjellë:

- rritje të produktivitetit dhe konkurrueshmërisë në eksport,
- reduktim të ndotjes dhe përmirësim të kushteve të punës,
- përfshirje më të gjerë të grave në proceset vendimmarrëse, duke krijuar **një model kombëtar të praktikave të integruara të “Punësimit të Gjelbër” (Green Employment.)**

4. Opsionet e politikave

Bazuar në gjetjet empirike dhe ndikimet e matura ekonomike e mjedisore, tranzicioni i drejt në Shqipëri kërkon një qasje të integruar që lidh politikat e punës me ato të mjedisit dhe zhvillimit ekonomik. Opsionet e mëposhtme ofrojnë një kornizë të mundshme ndërhyrjesh për të ndërtuar një **model të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës**.

Opsioni 1 – Integrim institucional dhe qeverisje ndërsektoriale

Qëllimi: Të sigurohet koherencë ndërmjet politikave të punës, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik, duke shmangur fragmentimin institucional.

Masat e propozuara:

- Krijimi i një **“Këshilli Kombëtar për Tranzicion të Drejtë”**, me mandat ligjor për koordinimin e politikave ndërsektoriale.
- Përfshirja e përfaqësuesve të ministrive përkatëse (Punë, Mjedis, Ekonomi), sindikatave, organizatave të punëdhënësve dhe shoqërisë civile.
- Hartimi i një **Strategjie Kombëtare për Tranzicion të Drejtë 2026–2030**, në përputhje me **ILO Guidelines** dhe **EU Green Deal**.

Efekti i pritshëm është rritja e koherencës institucionale dhe efikasitetit të burimeve publike; harmonizim i politikave me standardet europiane.

Opsioni 2 – Mbështetje financiare dhe teknologjike për ndërmarrjet

Qëllimi: Të përshpejtohet transformimi teknologjik dhe përmirësimi i kushteve të punës përmes mekanizmave të financimit të gjelbër.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Masat e propozuara:

- Përdorimi i fondeve **IPA III, BERZH**, dhe instrumenteve të BE-së për **investime në pajisje të gjelbra, trajnime me “green skills”, dhe procese riciklimi.**
- Vendosja e **kritereve prioritare për ndërmarrjet që punësojnë shumicë gra**, duke promovuar barazinë gjinore si kusht për mbështetje financiare.
- Krijimi i një **skeme grantesh pilot** për ndërmarrje që implementojnë sisteme të menaxhimit të energjisë dhe mbetjeve.

Efekti i pritshëm: Kursim energjie dhe mbetjesh në nivele 20–30%; rritje produktiviteti me 15–20%; stimulim i punësimit të grave në sektorin fason dhe prodhues.

Opsioni 3 – Fuqizim social dhe dialog i strukturuar

Qëllimi: Të garantohet që tranzicioni të jetë realisht “i drejtë” për punëtorët, me mbrojtje sociale dhe pjesëmarrje të barabartë.

Masat e propozuara:

- **Rivitalizimi i sindikatave** përmes mbështetjes teknike dhe përfshirjes në negociata kolektive;
- Vendosja e **mekanizmave të mediacionit social** për adresimin e ankesave dhe shkeljeve (mos-pagesa e orëve shtesë, kushtet e sigurisë, diskriminimi gjinor);
- Krijimi i **forumeve të përbashkëta punëtor–punëdhënës–qeveri**, të lidhura me Këshillin Kombëtar për Tranzicion të Drejtë.

Efekti i pritshëm është reduktimi i konflikteve të punës; rritje e kohezionit social; përmirësim i klimës së dialogut ndërmjet aktorëve.

Opsioni 4 – Përputhje me standardet ndërkombëtare dhe barazi gjinore

Qëllimi: Të integrohen standardet ndërkombëtare të punës dhe barazisë në të gjitha politikat e tranzicionit.

Masat e propozuar:

- Referencë e detyrueshme ndaj **ILO Conventions, EU Labour Standards, SDG 5** dhe **CEDAW**;
- Integrim i barazisë gjinore në çdo plan veprimi dhe raport monitorimi të tranzicionit të drejt;
- Përfshirje e grave në proceset e vendimmarrjes për planifikimin e investimeve të gjelbra.



This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Efekti i pritshëm është rritja e pjesëmarrjes së grave në rolet drejtuese; përputhje me standardet e BE-së për integrim dhe raportim vjetor.

Opsioni 5 – Pjesëmarrje aktive dhe partneritet strategjik

Qëllimi: Të ndërtohet një rrjet bashkëpunimi ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, institucioneve dhe sektorit privat për zbatim efektiv të politikave të gjelbra.

Masat e propozuara:

- Organizimi i **trajnimeve kombëtare** dhe **forumeve konsultative** për GADC dhe partnerët socialë mbi dialogun me vendimmarrësit;
- Zhvillimi i **rasteve pilot** për testimin e teknologjive të reja, matjen e ndikimit dhe shkëmbimin e përvojave;
- Krijimi i një **platforme digjitale për monitorim dhe transparencë** të politikave të tranzicionit.

Efekti i pritshëm është rritja e ndërgjegjësimit publik dhe përfshirjes së aktorëve lokalë; ndërtim i besimit ndërmjet sektorit publik dhe privat; zbatim i qëndrueshëm i praktikave të gjelbra.

Tabela 3 – Përmbledhja e opsioneve

Fusha Nderhyrjes	Instrumenti Politik	Efekti i Pritshëm	Koha Zbatimit
Qeverisje dhe Koordinim	Këshilli Kombëtar i Tranzicionit të Drejtë	Integrim institucional	2025–2026
Financim dhe Teknologji	Fonde IPA/BERZH dhe grante pilot	Kursim energjie, rritje produktiviteti	2026–2028
Dialog Social	Sindikata aktive dhe forume trepalëshe	Mbrojtje sociale, barazi gjinore	2026–2029
Përputhje me BE/ILO	Integrim standardesh ndërkombëtare	Harmonizim ligjor dhe institucional	2025–2030
Partneritet Shoqëror	Forume, trajnime, platformë digjitale	Rritje transparence dhe monitorimi	2025–2030

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

5. Analiza krahasuese ndërkombëtare

Për të kuptuar se cilat masa kanë më shumë gjasa të jenë të suksesshme në Shqipëri, janë shqyrtuar shembuj ndërkombëtarë.

Gjermania ka përdorur incentiva fiskale për kompanitë që adoptojnë teknologji të gjelbra, duke krijuar punë të reja dhe duke minimizuar ndikimin negativ të tranzicionit në sektorin energjetik.

Suedia ka zhvilluar programe trajnimi dhe riqualifikimi për punonjësit e industrive të prekura, duke siguruar mbështetje sociale dhe zbutur rezistencën e punonjësve.

Faktorët kryesorë të suksesit që mund të transferohen në Shqipëri përfshijnë: koordinim të ngushtë qeveri–sindikata–privat, incentiva financiare dhe mekanizma të qartë monitorimi. Adaptimi i këtyre praktikave duhet të marrë parasysh kapacitetet institucionale dhe burimet financiare lokale.

5.1. Sfidat ligjore dhe nevojat për ndryshim

Për të mundësuar zbatimin efektiv të Just Transition, janë identifikuar sfida ligjore konkrete.

Ligji për Energjinë dhe Burimet e Ripërtërishme duhet të përshtatet për të lehtësuar investimet private në energji të gjelbra dhe për të siguruar subvencione të qëndrueshme.

Ligji për Punën kërkon të rregullojë mbrojtjen e punonjësve që humbasin vendet e punës në sektorët e tranzicionit, duke ofruar trajnim dhe ripërtëritje të aftësive.

Ligji për Mjedisin duhet të sigurojë monitorim të vazhdueshëm të projekteve të energjisë dhe investimeve të qëndrueshme, duke parandaluar dëme të mundshme mjedisore.

Ky detajim ndihmon qeverinë të kuptojë saktësisht se çfarë ndryshimesh ligjore janë të nevojshme dhe të planifikojë procesin e tyre në mënyrë të koordinuar.

5.2. Vlerësimi i rrisqeve dhe skenarët alternativë

Zbatimi i Just Transition nuk është pa rreziqe. Skenari më i keq mund të përfshijë:

- Vonesa në trajnimet e punonjësve dhe ripërtëritjen e punësimit.
- Investime të papërfunduara në teknologji të gjelbra.
- Rezistencë nga aktorët socialë ose privatë.

Për të reduktuar këto rreziqe, rekomandohet krijimi i mekanizmave të mëposhtëm:

- **Monitorim dhe auditim i vazhdueshëm:** raportime periodike për progresin dhe problemet e identifikuara.



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

- **Fond rezervë për mbështetje emergjente:** për të siguruar mbështetje financiare në rast të vonesave ose dështimeve të projekteve.
- **Rishikim i politikave sipas treguesve të performancës:** të sigurojë fleksibilitet për korrigjime në kohë reale.

Ky plan menaxhimi rrisi rrisin e bën më të qëndrueshëm procesin e tranzicionit dhe rrit besueshmërinë e politikave për investitorët dhe punonjësit.

6. Rekomandimet dhe treguesit matës për një tranzicion të drejt dhe të qëndrueshëm

Për të arritur një tranzicion të drejt dhe të qëndrueshëm në sektorin e tekstilëve dhe këpucëve në Shqipëri, rekomandohet një qasje e integruar, e ndarë në komponentë të qarta ligjore, institucionale, sociale, ekonomike dhe gjinore.

Objektivat dhe treguesit matës përcaktohen në mënyrë SMART (Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe të Kohëzuara), duke lehtësuar monitorimin dhe raportimin për periudhën 2025–2030.

Rekomandimet Kryesore

➤ **Forcimi i kornizës ligjore dhe institucionale**

Veprimi: Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Tranzicion të Drejtë në vitin 2026 dhe krijimi i Task Force Ndërmënyshme për koordinimin e politikave

Efekt i pritshëm: Harmonizim i politikave kombëtare me standardet ndërkombëtare (ILO, EU Green Deal, CEDAW) dhe krijim i mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e punëtorëve gjatë tranzicionit

Tregues matës: Numri i dokumenteve ligjore dhe strategjive të miratuara, raportet e takimeve ndërmënyshme dhe integrimi i dimensionit gjinor në legjislacion

➤ **Mbështetje financiare dhe teknologjike për ndërmarrjet**

Veprimi: Implementimi i skemave pilot për 50 ndërmarrje fason duke përdorur fonde IPA III, BERZH dhe instrumente të BE-së për pajisje energjetike dhe riciklim

Efekt i pritshëm: Kursim energjie dhe reduktim të mbetjeve deri në 30%, rritje e produktivitetit deri në 20% dhe avancim i aftësive “green skills” për punonjësit

Tregues matës: Numri i ndërmarrjeve të mbështetura, reduktimi i konsumit energjetik dhe i mbetjeve dhe raportet për implementimin e teknologjive të gjelbra

➤ **Dialog social i strukturuar dhe fuqizim i punëtorëve**





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Veprimi: Rivitalizimi i sindikatave dhe krijimi i forumeve trepalëshe punëtor–punëdhënës–qeveri si dhe mekanizma mediacioni për ankesa

Efekt i pritshëm: Rritje e pjesëmarrjes së punëtorëve në vendimmarrje, reduktim i konfliktualitetit dhe forcim i mbrojtjes sociale dhe të drejtave të grave

Tregues matës: Përqindja e punëtorëve të përfaqësuar nga sindikata, numri i marrëveshjeve kolektive dhe raportet e ankesave të zgjidhura

➤ **Integrim me standardet ndërkombëtare dhe promovim i barazisë gjinore**

Veprimi: Referencë detyruese ndaj ILO Conventions, SDG 5 dhe CEDAW në të gjitha politikat dhe projektet e tranzicionit dhe zhvillimi i trajnimeve dhe programeve për përfshirjen e grave në vendimmarrje

Efekt i pritshëm: Pjesëmarrje e barabartë gjinore në role drejtuese, përputhje ligjore dhe institucionale me BE-në dhe raportim vjetor i integruar

Tregues matës: Përqindja e grave në role vendimmarrëse dhe numri i programeve të trajnimit dhe certifikimeve për barazi gjinore

➤ **Promovimi i partneritetit dhe inovacionit**

Veprimi: Organizimi i trajnimeve kombëtare, krijimi i platformës digjitale për monitorim, testimi i teknologjive të reja dhe shkëmbimi i praktikave

Efekt i pritshëm : Përfshirje aktive e aktorëve lokalë, transparencë dhe monitorim efektiv dhe zbatim i qëndrueshëm i praktikave të gjelbra

Tregues matës: Numri i forumeve dhe trajnimeve të zhvilluara, përdorimi i platformës digjitale dhe aplikimi i teknologjive të reja në fabrika

Tabela 4 – Objektivat SMART dhe Treguesit Matës të Tranzicionit të Drejt (2025–2030)

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi SMART	Koha e Zbatimit	Tregues Matës
Politika Publike	Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Tranzicion të Drejtë	2026	Dokument strategjik i miratuar dhe publik
Dialog Social	Rritja me 30% e marrëveshjeve kolektive në sektor	2027	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara dhe raportet e negociatave



This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Fusha e Ndërhyrjes	Objektivi SMART	Koha e Zbatimit	Tregues Matës
Mbështetja e Biznesit	50 ndërmarrje të përfshira në skema për tranzicion të gjelbër	2028	Numri i ndërmarrjeve me projekte të implementuara; reduktim % i konsumit energjie dhe mbetjeve
Barazia Gjinore	40% e grave në pozicione vendimmarrëse në ndërmarrje dhe Task Force	2028	% grave në role drejtuese; raportet e trajnimeve dhe programeve të avancimit
Partneritet dhe Transparencë	Krijimi i platformës digjitale dhe organizimi i forumeve konsultative	2025–2030	Numri i forumeve, përdoruesve të platformës dhe rasteve pilot të ndjekura

7. Konkluzione

Tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër në Shqipëri paraqet një mundësi të jashtëzakonshme për të ndërtuar një model zhvillimi të qëndrueshëm, që integron punën, mjedisin dhe barazinë sociale.

Analiza empirike tregon qartë se ndërmarrjet dhe institucionet aktualisht operojnë në një terren fragmentar, me boshllëqe në trajnime, koordinim institucional dhe mbështetje financiare.

Megjithatë, rastet pilot dëshmojnë se edhe praktikatat e thjeshta, si riciklimi i mbetjeve, eficienta energjetike dhe përfshirja aktive e grave në vendimmarrje, sjellin përfitime konkrete për punonjësit, bizneset dhe ambientin.

Rrugëtimi drejt zbatimit të politikave të Tranzicionit të Drejtë tregon nevojën për veprime të strukturuar dhe të koordinuara në tre faza: hartimi ligjor dhe krijimi i mekanizmave koordinues, pilotimi i programeve dhe investimeve të gjelbra, dhe implementimi i plotë i indikatorëve me monitorim të vazhdueshëm.

Mbështetja financiare dhe teknologjike, fuqizimi i dialogut social, përputhja me standardet ndërkombëtare dhe trajnimi i punonjësve janë elementë kyç për të siguruar një tranzicion të drejtë dhe efektiv.

Përmes politikave të integruara, përdorimit të treguesve SMART dhe zbatimit të praktikave të gjelbra, Shqipëria ka mundësinë të zhvillojë një sektor prodhues konkurrues, që garanton punë cilësore, barazi gjinore dhe përfitime mjedisore.



Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Pa ndërhyrje urgjente, ekziston rreziku i stagnimit dhe i përjashtimit social; me implementim të qëndrueshëm, ky proces mund të kthehet në një model kombëtar dhe rajonal, që shërben si shembull i zhvillimit ekonomik të gjelbër dhe të drejtë.

Në përfundim, ky punim tregon se **Tranzicioni i Drejtë nuk është thjesht një objektiv ligjor apo ambiental**, por një strategji integruese që lidhet direkt me mirëqenien e punonjësve, rritjen e efikasitetit ekonomik, përmirësimin e kushteve të punës dhe promovimin e barazisë gjinore.

Zbatimi i saj efektiv mund të transformojë praktikat sporadike të biznesit shqiptar në një kornizë kombëtare të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përputhës me agjendën e gjelbër europiane.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

Referenca bibliografike

1. International Labour Organization (ILO)

- ILO. (2015). Guidelines for a Just Transition towards environmentally sustainable economies and societies for all. Geneva: ILO.
- ILO. (2021). Skills for a Green Economy. Geneva: ILO.
- ILO. (2020). Labour Overview: Albania. Geneva: ILO.

2. United Nations Industrial Development Organization (UNIDO)

- UNIDO. (2020). Industrial Development Report 2020: Industrialization for a Sustainable Future. Vienna: UNIDO.
- UNIDO. (2019). Green Industry Platform: Case Studies and Guidelines.

3. Laudes Foundation

- Laudes Foundation. (2021). Just Transition in the Global Apparel Sector: Insights and Recommendations.

4. Clean Clothes Campaign (CCC)

- Clean Clothes Campaign. (2022). Working Conditions in the Global Garment Industry: Evidence and Advocacy.
- Clean Clothes Campaign. (2020). Case Studies: Fair Wages and Environmental Sustainability.

5. European Union / EU Green Deal Documentation

- European Commission. (2019). The European Green Deal. Brussels: European Commission.
- European Commission. (2020). EU Strategy for Sustainable and Circular Textiles.

6. Qeveria Shqiptare – Dokumente Strategjike

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2020–2025). Strategjia Kombëtare e Zhvillimit dhe Integritimit 2030.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2020–2025). Strategjia Kombëtare e Punësimit.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). Raport për Mbrojtjen Sociale dhe Sigurimet Shoqërore.
- Inspektorati Shtetëror i Punës. (2022). Raporte Vjetore mbi Marrëdhëniet e Punës dhe Marrëveshjet Kolektive.

7. Organizata të Shoqërisë Civile dhe Sindikata

- Sindikata e Punonjësve të Fasonerive. (2022). Raport mbi Marrëdhëniet Kolektive dhe Trajnimet për Punëtorët.
 - **Publikime dhe Studime Ndërkombëtare të Sektorit të Veshjeve**
- ETUC (European Trade Union Confederation). (2021). Just Transition and Labour Rights in the European Textile Sector.





Co-funded by
the European Union

This event is part of the “Fashioning A Just Transition” project (2024-2027)

- OECD. (2020). Environmental Policy and Industrial Transformation: Case Studies in EU Candidate Countries.

Anekse

- Aneks 1. Pyetësor për administratorët e fabrikave të prodhimit të veshjeve
- Aneks 2. Pyetësor për punonjësit e fabrikave të prodhimit të veshjeve
- Aneks 3. Pyetësor për insitucionet publike
- Aneks 4. Pyetësor për Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
- Aneks 5. Pyetësor për Sindikatat

